



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MAJLINDA DEMOLLARI
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA
NR .10
TEL: 0682061560

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 7924

Nr. koleksioni: 2614

Tirane më 11/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053790267183684

*Akti noterial përbëhet nga 8 fletë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 7924 REP.
NR. 2614 KOL.

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot, më datë 11 10 2021 (dymijë e njëzet e një) para meje Majlinda E. Demollari, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, më adresë në Rrugën "Yaso Pasha", u paraqitën personalisht palët.

Z. Bujar Hasaj, atësia: Kovaç, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Peshtan i Madh, Fier në datën 15.02.1961, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 033768902 dhe nr. Personal G10215236F. Me të dhëna kontakti: adresë banimi: Rruga "Ismail Qemali" Nr. 5, Tiranë, **zotërues i 100 % të kapitalit të shoqërisë IBN shpk me NUIS L21309010H**, me adresë në Rrugën e "Dafinave", Kompleksi i ndërtimeve IBN shpk, Godina 4, kati i parë, në fund të shëtitorës, ish-Fusha e Aviacionit, afër shkollës 9-vjeçare "Dhora Leka", Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë,

nga këtu e më poshtë referuar si "Shitësi".

dhe

Shoqëria B-2 shpk regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me Numer Unik Identifikimi të subjektit (NUIS) **M01801014N**, me seli në: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 34/1, Nr. 5, Hyrja 5, pasuria Nr. 2/827-N3, kodi postar 1019, Tirane, përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm dhe njëherazi Administratori, **Z. Bujar Hasaj**, atësia: Kovaç, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Peshtan i Madh, Fier në datën 15.02.1961, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 033768902 dhe nr. Personal G10215236F. Me të dhëna kontakti: adresë banimi: Rruga "Ismail Qemali" Nr. 5, Tiranë

nga këtu e më poshtë referuar si "Blerësi".

Baza ligjore e kontratës:

- Nenet: 72, 73 e vijues, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- Neni 9 pika 9.1 b) i Statutit të shoqërisë IBN shpk.
- Ligji Nr. 110/2018 "Për Noterinë";

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të **100 % (njëqind përqind)** të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, me një vlerë totale prej **ALL 100,000 (njëqindmijë lekë)**, që Shitësi zotëron në shoqërinë **IBN shpk me NUIS L21309010H**, me adresë në Rrugën e "Dafinave", Kompleksi i ndërtimeve IBN shpk, Godina 4, kati i parë, në fund të shëtitorës, ish-Fusha e Aviacionit, afër shkollës 9-vjeçare "Dhora Leka", Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë.

Neni 2

Çmimi i shitjes

Pala Blerëse i paguan Palës Shitëse çmimin e shitjes **ALL 100,000 (njëqindmijë lekë)** për 100 kuotat me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë/secila që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Çmimi i Shitjes paguhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Neni 3
Detyrimet e Palëve

- 3.1 Kuotat e Shitura nga Palët Shitëse dhe çdo e drejtë dhe detyrimi i cili buron prej këtyre dy kuotave, i kalojnë/transferohen në pronësi Palës Blerëse shoqërisë B-2 Shpk menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, ortaku aktual i të Shoqërisë IBN shpk Z. Bujar Hasaj, përkatësisht shitësi, humbet pronësinë dhe nuk do të jetë më zotërues/pronar të kuotave të shitura tek pala Blerëse shoqëria B-2 Shpk.
- 3.2 Pala Blerëse fiton pronësinë e kuotave me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes të këtyre kuotave dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të këtyre kuotave, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (tatim mbi vlerën e shtuar, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifatat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat, faturime nga OSHEE dhe UKT etj); ndaj të tretëve, shoqërive tregtare dhe personave fizik (çdo e drejtë/detyrim i cili rrjedh nga kontrate qiraje, shërbimi, enfitoteze, leasing, kredi, huaje etj) apo çdo e drejtë/detyrim ndaj shoqërive tregtare dhe/ose organizate jo-qeveritare që Shoqëria IBN shpk, përfshirë çdo të drejtë/detyrim i/e cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose/dhe kontraktuale i takon palës Blerëse.

Neni 4
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve dhe përcillet në QKB.

Kontrata Ju lexua dhe shpjegua palëve me zë të lartë dhe të qartë nga unë noteri. Palët lexuan dhe kuptuan përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe pasi panë se përmbajtja e kontratës është e njëjtë me dëshirën dhe vullnetin e lirë dhe të pavesuar të tyre, duke pranuar këtë kontratë dhe efektet e saj nënshkruajnë rregullisht kontratën në çdo faqe dhe në prani të noterit. Kontrata mbi kërkesën e palëve dhe sipas ligjit Nr. 110/2018 datë 20.12.2018 "Për Noterinë" hartohet në katër kopje origjinale, nga të cilat një kopje origjinale qëndron pranë kësaj zyre noteriale duke u arkivuar sipas ligjit në fuqi, një kopje origjinale i jepet palës shitëse dhe dy kopje të tjera origjinale i jepen palës blerëse.

Unë noteri pasi konstatova se akti i mësipërm është në pajtim të plotë me vullnetin e palëve dhe me ligjin në fuqi e nënshkruaj këtë akt rregullisht sipas ligjit në fuqi.

SHITËSI
Z. BUJAR HASAJ

Palët:
BLERËSI
SHOQËRIA B-2 SHPK
Ortaku i vetëm dhe administratori
BUJAR HASAJ

Bujar Hasaj

Bujar Hasaj

NOTERE
Majlinda E. Demollari
Nr. 7: 291600040A
746 0682041560

